



BANKA QENDRORE E REPUBLIKES SË KOSOVËS  
CENTRALNA BANKA REPUBLIKE KOSOVA  
CENTRAL BANK OF THE REPUBLIC OF KOSOVA

# NGARKESA ME BORXH E KLIENTËVE BANKARË NË KOSOVË

Numër | 01

Gusht | 2015



BANKA QENDRORE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS  
CENTRALNA BANKA REPUBLIKE KOSOVA  
CENTRAL BANK OF THE REPUBLIC OF KOSOVO

# Ngarkesa me borxh e klientëve bankarë në Kosovë

Numër 1

## Përmbledhje



**BOTUES** © Banka Qendrore e Republikës së Kosovës  
Departamenti i Analizave Ekonomike dhe Stabilitetit Financiar  
33 Garibaldi, Prishtinë 10 000  
Tel: ++381 38 222 055  
Fax: ++381 38 243 763

**Faqja e internetit** [www.bqk-kos.org](http://www.bqk-kos.org)

**Adresa elektronike** [economic.analysis@bqk-kos.org](mailto:economic.analysis@bqk-kos.org)

**KRYEREDAKTOR** Arben MUSTAFA

**REDAKTOR** Albulena XHELILI

**AUTOR** Krenare MALOKU

**BASHKËPUNËTORË** Divizioni i Regjistrimit të Kredive të Kosovës (RKK)

**REDAKTOR TEKNIK** Butrint BOJAJ

**Vërejtje:** Përdoruesit e këtyre të dhënave kërkohen të citojnë burimin.  
Citimi i sugjeruar: Banka Qendrore e Republikës së Kosovës (2015),  
Ngarkesa me Borxh e Klientëve Bankarë në Kosovë nr. 1, Prishtinë: BQK.  
Çdo korrigjim i nevojshëm bëhet në verzionin elektronik.



## PËRMBAJTJA:

1. Qëllimi i studimit	6
2. Metodologjia e studimit	8
2.1. Burimi i të dhënave	8
2.2. Mostra e studimit	8
2.3. Procedura e përzgjedhjes së mostrës	8
2.4. Të dhënat e shfrytëzuara dhe kufizimet	9
2.5. Përkufizimi i ngarkesës me borxh	10
2.6. Përpunimi i të dhënave	12
3. Përmbledhje e rezultateve	13
3.1. Trendet e huamarrjes	13
3.2. Performanca e pagesës	14
3.3. Ngarkesa me borxh	15
3.4. Ndërlidhja mes indikatorëve të ndryshëm të ngarkesës	18
4. Përfundim	19
4.1. Kufizimet e Studimit	20
5. Rekomandime	22
6. Referenca	24





## 1. Qëllimi i studimit

Banka Qendrore e Republikës së Kosovës, në kuadër të përpjekjeve të vazhdueshme që të siguroj stabilitet financiar dhe ambient sa më të favorshëm për operim të institucioneve financiare, ka filluar realizimin e studimit mbi trendet e huamarrjes dhe nivelin e ngarkesës me borxh të klientëve kreditorë në Kosovë, i cili do të përpilohet një herë në vit.

Me zhvillimin e vazhdueshëm të sektorit financiar dhe zgjerimin e mundësive për qasje në produkte kreditore, rreziku i ngarkesës me borxh të klientëve ka filluar të marrë vëmendjen e publikut dhe politikbërësve. Mbingarkesa me borxh e huamarrësve, përveç rrezikut direkt që paraqet për stabilitetin e sektorit financiar, ngërthen në vete edhe pasoja sociale dhe psikologjike për të ngarkuarit dhe shoqërinë si tërësi.

Qëllimi kryesor i këtij studimi është të analizojë nivelin e ngarkesës me borxh për të vlerësuar nëse klientët kreditorë në Kosovë janë të mbingarkuar me borxh apo rrezikojnë të kenë probleme me mbingarkesë. Përveç kësaj, studimi synon të identifikojë modelet e huamarrjes së klientëve kreditorë, si dhe të identifikojë faktorët që mund të kenë ndikuar në kapacitetin e huamarrësit për të shlyer detyrimet kreditore. Sigurimi i informacionit të tillë në baza periodike ofron bazë për diskutim në lidhje me masat e nevojshme për parandalimin e problemeve të mundshme të rrezikut kreditor.

Një studim i ngjashëm që hulumtoi çështjen e ngarkesës me borxh të klientëve kreditorë në Kosovë është kryer më parë nga Fondi Evropian për Evropën Juglindore (EFSE). Sidoqoftë, për të siguruar kontinuitetin e vlerësimit të rrezikut të ngarkesës me borxh dhe ndërmarrjen e veprimeve adekuate për kontrollim të këtij rreziku, i cili gjithnjë e më tepër po merr vëmendje në vendet e BE-së si dhe në vendet e Evropës Juglindore, BQK-ja konform mandatit dhe objektivave të saj strategjike për ruajtjen e stabilitetit financiar ka marrë përsipër përpilimin e këtij studimi në baza periodike<sup>1</sup>.

Në studimin e parë të kësaj natyre, BQK-ja është fokusuar në analizimin e trendëve të huamarrjes dhe vlerësimit të gjendjes së rrezikut të mbingarkesës me borxh të klientëve të 7 (shtatë) bankave komerciale,<sup>2</sup> me kredi aktive në vlerën prej 5,000 – 50,000 euro.

Studimi strukturor rreth dy subjekteve kyçe: a) huamarrësve, ku theksi bie në identifikimin e karakteristikave socio-demografike të klientëve të përzgjedhur si mostër, modelet e tyre të huamarrjes, si dhe performancën në pagesë dhe nivelin e ngarkesës me borxh, dhe b) kontratave kreditore, ku në fokus të analizës është kontrata kreditore dhe jo huamarrësi. Në këtë pjesë analizohen të dhënat për të gjitha kontratat kreditore aktive të huamarrësve të përzgjedhur si mostër, me theks në karakteristikat kryesore të kontratave dhe ndërlidhjen e tyre me performancën e pagesës.

Qëllimet specifike të studimit apo pyetjet që synohen të adresohen janë:

- 1) Cilat janë karakteristikat demografike të klientëve kreditorë në segmentin e kredive nga 5,000 – 50,000 euro;
- 2) Cilat janë shprehjet kryesore të huamarrjes së këtyre klientëve; cilat janë karakteristikat kryesore të kontratave të tyre kreditore (për shembull, qëllimi i kredive, kohëzgjatja, kolaterali, etj.);

<sup>1</sup> Ky studim ka strukturë të ngjashme me studimet paraprake të ngarkesës të realizuara nga EFSE. Sidoqoftë, rezultatet nuk janë gjithmonë të krahasueshme përshkak të ndryshimit të intervalit të kredive mostër.

<sup>2</sup> Ky projekt studimor, i cili do të realizohet në baza të rregullta, synon të përfshijë të gjitha bankat komerciale që operojnë në Kosovë dhe të cilat kanë historik kreditor të mjaftueshëm.

- 3) Si është performanca e pagesës së kontratave kreditore, trendet e pagesës dhe faktorët që ndikojnë në performancën e pagesës;
- 4) Si është gjendja e ngarkesës me borxh të klientëve dhe cilët faktorë mund të kenë ndikim në nivelin e ngarkesës.

## 2. Metodologjia e studimit

### 2.1. Burimi i të dhënave

Studimi është bazuar në shfrytëzimin e të dhënave të Regjistrimit të Kredive të Kosovës (RKK) dhe në të dhëna të Sistemit të Menaxhimit të Informacionit të bankave të përfshira në studim. Burimi kryesor i të dhënave ishte databaza e RKK-së, në të cilën institucionet financiare në baza të rregullta raportojnë të dhëna kyçe mbi klientët kreditor në Kosovë dhe historikun e tyre kreditor, përfshirë pjesëmarrjen në rolin e garantuesit, bashkëhuamarrësit, etj. Sidoqoftë, të dhëna të rëndësishme për studim, si të dhënat demografike dhe të dhëna mbi të hyrat e huamarrësve, të cilat nuk janë të plota në RKK, janë marrë nga bankat e përfshira në studim.

### 2.2. Mostra e studimit

Studimi është fokusuar në analizimin e trendeve të huamarrjes dhe rrezikut të mbingarkesës me borxh të klientëve të 7 (shtatë) bankave komerciale,<sup>3</sup> me kredi aktive në dhjetor 2013, shumë e aprovuar e të cilave shtrihej në intervalin 5,000 – 50,000 euro.

Mostra e përgjithshme e studimit është përzgjedhur nga popullacioni i klientëve të të gjitha bankave në Kosovë me kredi aktive në dhjetor 2013 në segmentin e kredive të përzgjedhur për studim. Të dhënat për gjithsej numrin e klientëve janë marrë nga RKK. Bazuar në shtrirjen në treg të institucioneve të përfshira në studim, mostra përfaqëson 93% të gjithsej tregut të kredive në aspektin e numrit të klientëve për segmentin e përcaktuar.

Mostra, e cila është përzgjedhur duke respektuar nivelin e besueshmërisë prej 95% dhe margjinën e gabimit 3%, fillimisht përfshinte gjithsej 1,055 klientë. Megjithatë, mostra fillestare është rritur për 10 përqind për të reflektuar mundësinë e përzgjedhjes së klientëve të njëjtë nga më shumë se një institucion, si dhe mundësinë e mungesës së plotë të të dhënave dhe gabimeve eventuale. Mostra përfundimtare e studimit përfshinë 1,160 klientë. Shpërndarja e mostrës për bankat e përfshira në studim është bërë duke u bazuar në pjesëmarrjen e bankave përkatëse në segmentin e përzgjedhur të tregut.

### 2.3. Procedura e përzgjedhjes së mostrës

Në mënyrë që mostra të jetë valide dhe reprezentative për popullacionin, ajo është përzgjedhur në mënyrë të rastësishme. Përzgjedhja e rastësishme e mostrës është bërë nga vetë bankat, të cilat janë udhëzuar që të respektojnë procedurat në vijim:

- Të listojnë numrat personal apo numrat e regjistrimit të bizneseve (ID-të) të të gjithë klientëve me kredi në shumën 5,000 - 50,000 euro, të cilat kanë qenë aktive deri më datën 31 dhjetor 2013;
- Të përzgjedhin në mënyrë të rastësishme numrin e klientëve në përputhje me mostrën e përcaktuar për institucionin e tyre;
- Të krijojnë kode për klientët e përzgjedhur duke përdorur numrin identifikues të institucionit të tyre<sup>4</sup> dhe numrin rendor;
- Të plotësojnë të dhënat e kërkuara me informata nga Sistemi i Menaxhimit të të Dhënave;

<sup>3</sup> Qëllimi i studimit, i cili do të realizohet në baza të rregullta, është të përfshijë të gjitha bankat komerciale që operojnë në Kosovë, dhe të cilat kanë historik kreditor të mjaftueshëm. Në periudhën e fillimit të studimit, vetëm 7 nga gjithsej bankat kanë plotësuar këtë kriter.

<sup>4</sup> Numri identifikues i bankës është kërkuar të jetë i njëjti me atë që përdoret për raportimin e të dhënave në Regjistrin e Kredive të Kosovës.

- Të dërgojnë të dhënat në Regjistrin e Kredive të Kosovës (RKK), ku janë ekstraktuar të dhënat shitesë nga regjistri për të gjithë klientët e përzgjedhur.

Databaza e kompletuar e të dhënave, e koduar për të ruajtur konfidencialitetin e të dhënave personale të klientëve, është dërguar nga RKK te Departamenti i Analizave Ekonomike dhe Stabilitetit Financiar, i cili ka bërë përpunimin e të dhënave, nxjerrjen dhe analizimin e rezultateve.

#### 2.4. Të dhënat e shfrytëzuara dhe kufizimet

Të dhënat<sup>5</sup> e kërkuara nga bankat kryesisht kanë përfshirë të dhëna demografike, të hyrat mujore bruto dhe neto të ekonomive familjare dhe bizneseve si dhe të dhëna për kreditë e klientit të përzgjedhur. Nga të dhënat për kreditë, me rëndësi të veçantë kanë qenë të dhënat për të cilat bankat nuk janë të obliguara të raportojnë në Regjistrin e Kredive, siç janë këstet e paguara për secilën kredi dhe qëllimet e kredive përkatëse. Të dhënat tjera, të cilat u ekstraktuan nga RKK përfshijnë raporte të detajuara kreditore të klientëve përkatës, përfshirë karakteristika të kontratave të tyre kreditore, klasifikimin e kontratave kreditore, të dhëna mbi kolateralin, të dhëna rreth angazhimit të klientëve në role tjera si garantues, bashkëhuamarrës, etj.

Sidoqoftë, procesi i përpilimit të këtij studimi është ballafaquar me disa kufizime në të dhëna të cilat mund të kenë ndikuar në mbi apo nën vlerësimin e rezultateve të studimit. Andaj, këto kufizime duhet të merren parasysh gjatë interpretimit të gjetjeve të këtij studimi. Kufizimet në të dhëna kryesisht përbëhen nga:

##### **Mungesa e të dhënave të sakta për këstet e kredive**

Shuma e këstit të kredisë nuk është variabël që kërkohet detyrimisht të raportohet në Regjistrin e Kredive. Shuma e këstit të kredive për klientët e përfshirë në këtë studim është marrë nga bankat, mirëpo vetëm për kreditë të cilat janë lëshuar nga po ato banka. Të dhënat për shumën e këstit të kontratave kreditore që klientët e mostrës i kishin nga institucione të tjera nuk ishin të plota, andaj është dashur të bëhen supozime për të kalkuluar shumën e përgjithshme që klientët e paguajnë për shlyerjen e kontratave aktive kreditore.

Llogaritja e këstit për kontrata kreditore të cilat nuk kanë pasur informacion mbi këstin është bërë duke supozuar pagesa të barabarta të këstit gjatë gjithë kohëzgjatjes së kredisë, si dhe duke supozuar që kontrata kreditore ka normë të interesit të barabartë me mesataren e normës së interesit të ofruar nga të gjitha bankat për produktin kreditor përkatës.

Normat mesatare vjetore të interesit të përdorura për llogaritjen e këstit, të ndara sipas produkteve kreditore, janë si në vijim:

- Kredi dhe Lizing: 11.8%
- Mbitërheqje: 16.0%
- Kredit kartelë (Norma mujore ndëshkuese për shumën e vonuar): 23.8%

Mosposedimi i të dhënave të sakta mbi shumën e këstit të kredisë mund të shkaktojë devijim të rezultateve sepse normat e interesit ndryshojnë sipas institucionit, llojit dhe kushteve të kredisë, kështu që mund të ketë raste kur janë nënvlerësuar apo mbivlerësuar këstet që paguhet nga klientët. Gjithashtu, këstet mund të mos jenë të shpërndara në mënyrë të barabartë gjatë gjithë kohëzgjatjes së kontratës, ku bankat mund të aplikojnë periudha të lirimit nga pagesa e këstit,

<sup>5</sup> Lista e detajuar e të dhënave të kërkuara nga bankat si dhe ato të marra nga Regjistri i Kredive gjenden në Aneksin 2 të publikimit.

apo të negociojnë pagesa të njehershme të kredisë. Në këto raste, vlerësimi i ngarkesës me borxh mund të mos jetë i saktë.

### **Subjektiviteti dhe mos përputhja e mundshme e të hyrave mujore**

Të dhënat për të hyrat mujore të klientëve janë marrë nga bankat, të cilat në shumicën e rasteve kanë marrë këto informata nga dosjet e kredive të klientëve përkatës. Ekzistojnë disa probleme të mundshme me këto të dhëna, të cilat mund të jenë reflektuar në rezultatet e studimit. Njëri nga problemet e mundshme, që është theksuar edhe nga bankat, është mospërputhja ndërmjet bankave të ndryshme, por edhe përbrenda të njëjtës bankë, në mënyrën e vlerësimit të të hyrave të klientëve. Kjo për arsye të përdorimit të kriterëve të ndryshme për vlerësimin e të hyrave, si dhe mundësisë së subjektivitetit në vlerësimin e shpenzimeve në rastin e neto të hyrave të disponueshme.<sup>6</sup>

Neto të hyrat e disponueshme në rastin e ekonomive familjare është kërkuar të përfshijnë të hyrat totale bruto pas zbritjes së taksave dhe shpenzimet mujore të ekonomisë familjare. Në shpenzime është kërkuar që të mos përfshihen pagesat për këstet kreditore të cilat klienti i paguan bankës në fjalë apo ndonjë institucioni tjetër kredidhënës në Kosovë, në mënyrë që të mund të llogaritet barra reale e këstit ndaj të hyrave neto. Sidoqoftë, bankat zakonisht marrin informacionet për të hyrat e klientëve në kohën kur klientët raportojnë për kredi dhe në shpenzime i përfshijnë edhe këstet të cilat klienti ua paguan institucioneve të tjera. Rrjedhimisht, mund të ketë raste kur bankat kanë pasur vështirësi për identifikimin e shpenzimeve rreth kësteve kreditore; andaj, të hyrat neto reflektojnë edhe këto shpenzime që nënkupton se ngarkesa me borxh mund të jetë mbivlerësuar.

Një problem tjetër me të dhënat për të hyrat mujore neto mund të jetë mos përfshirja e shpenzimeve për obligimet kreditore që kanë anëtarët e tjerë të familjes. Këto shpenzime mund të mos jenë reflektuar në shpenzimet e ekonomisë familjare, duke ndikuar në rritjen e të hyrave dhe nënvlerësimin e ngarkesës me borxh.

Dimensioni i kohës, që nënkupton supozimin e të hyrave të qëndrueshme mujore pa marrë parasysh ndryshimet e mundshme në të hyra gjatë periudhës së zgjatjes së kontratës kreditore, mund të jetë një problem tjetër në vlerësimin e ngarkesës me borxh. Të hyrat për klientë mbledhen nga bankat në momentin e lëshimit të kredisë dhe supozohen të pandryshueshme përgjatë periudhës sa zgjatë kontrata kreditore. Kjo bën që të dhënat në dispozicion të mos reflektojnë ndryshimet e mundshme në të ardhura në periudhën pas aprovimit të kredisë, të cilat mund të përmirësojnë ose përkeqësojnë nivelin e mbingarkesës me borxh dhe rrjedhimisht kapacitetin e kredimarrësit për të ripaguar kredi në pagesë.

## **2.5. Përkufizimi i ngarkesës me borxh**

Literatura botërore si dhe studime të ndryshme për ngarkesën me borxh përdorin definicione të ndryshme të ngarkesës dhe indikatorë të ndryshëm të vlerësimit të saj (D'Alessio & Iezzi, 2013). Ndër definicionet më të përdorura janë ai në Mbretërinë e Bashkuar i cili fokusin e vendosë në borxhin e mbetur (vonesat) në pagimin e faturave të rregullta (përfshirë këstet kreditore), ku ngarkesa me borxh konsiderohet situata kur familjet ose individët janë në vonesë në bazë strukturore (vonesa të vazhdueshme për disa muaj), ose janë në rrezik të konsiderueshëm të hyjnë në kategorinë e vonesave strukturore (OXERA, 2004). Definicion tjetër më i përdorur është ai në Gjermani që me mbingarkesë nënkupton situatën kur të ardhurat e një familje, përkundër uljes së standardit jetësor, janë të pamjaftueshme për kryerjen e të gjitha obligimeve të pagesave

<sup>6</sup> Ndryshueshmëria e kriterëve dhe subjektiviteti në përlogaritjen e shpenzimeve ka të bëjë me vlerësimin e shpenzimeve të rregullta mujore të cilat raportohen nga klientët, çfarë përfshihet në këto shpenzime, si dhe mënyra e përlogaritjes së mesatares mujore të këtyre shpenzimeve.

për një periudhë më të gjatë kohore (Haas, 2006). Komisioni Evropian në vitin 2008 ka bërë një studim për përcaktimin e një definicioni më gjithëpërfshirës dhe të përbashkët për vendet e BE-së, sipas të cilit janë identifikuar kriteret kryesore për vlerësimin e ngarkesës me borxh. Elementet kryesore që duhet të merren parasysh janë: a) Ngarkesa me borxh duhet të vlerësohet në nivel të ekonomisë familjare dhe jo në nivel të individit, ngase ekonomitë familjare bashkojnë resurset – të hyrat dhe shpenzimet; b) Indikatorët duhet të përfshijnë të gjitha obligimet financiare, përfshirë të gjitha llojet e kontratave kreditore por edhe pagesave të faturave mujore të rregullta; c) Mbingarkesa nënkupton pamundësinë për të paguar shpenzime të përsëritshme (çdo muaj) andaj duhet të konsiderohet si problem i vazhdueshëm dhe jo i përkohshëm; ç) Problemi nuk mund të zgjidhet duke marrë më shumë borxh; dhe d) Problemi kërkon zvogëlim të dukshëm të shpenzimeve apo rritje e burimeve dhe nivelit të hyrave. Definicioni, megjithëse gjithëpërfshirës, paraqet probleme praktike në rastin e matjes. Indikatorët kryesorë, të cilët respektojnë shumicën e parimeve të lartëcekura dhe të cilët përdoren për vlerësimin e ngarkesës me borxh janë (BIS, 2010):

- a) Vonesa në pagesën e obligimeve kreditore dhe/apo faturave mujore shtëpiake për më shumë se 3 muaj;
- b) Shpenzimi i më shumë se 25% të hyrave mujore bruto në pagesën e borxhit të pasiguruar;
- c) Shpenzimi i më shumë se 50% të hyrave mujore bruto në pagesën e gjithsej borxhit të siguruar dhe të pasiguruar;
- d) Deklarimi që obligimet e borxhit janë barrë e rëndë në të hyrat e tyre;
- e) Posedimi i katër apo më shumë se katër kontratave kreditore;

Në këtë studim, ngarkesa me borxh është vlerësuar duke respektuar parimet e mësipërme për të konstruktuar indikatorë për të cilët ekzistojnë të dhënat. Indikator i kryesor për matjen e nivelit të ngarkesës me borxh (**indeksi i ngarkesës me borxh**) është definuar si raporti ndërmjet **shumës së kësteve mujore në të gjitha kontratat kreditore dhe neto të hyrave mujore**.

Indeksi është llogaritur ndaras për ekonomitë familjare dhe për bizneset. Niveli i ngarkesës së huamarrësve është ndarë në katër klasifikime, varësisht prej vlerës së indeksit.

- 1) **Të pangarkuar (indeksi i ngarkesës me borxh < 0.50):** huamarrësit të cilët shpenzojnë më pak se 50% të hyrave mujore neto, apo të profitit pas taksave në rastin e ndërmarrjeve, në pagesën e kësteve kreditore mujore.
- 2) **Në rrezik (indeksi i ngarkesës me borxh = 0.50 – 0.75):** huamarrësit të cilët shpenzojnë 50% deri në 75% të hyrave mujore neto apo profitit në pagesën e kësteve kreditore mujore.
- 3) **Në fazë kritike (indeksi i ngarkesës me borxh = 0.75 – 1.0):** huamarrësit të cilët shpenzojnë 75% deri në 100% të të hyrave mujore neto apo profitit në pagesën e kësteve kreditore mujore.
- 4) **Josolvent (indeksi i ngarkesës me borxh > 1.0):** huamarrësit të cilët shpenzojnë gjithë të hyrat mujore neto apo profitin në pagesën e kësteve kreditore mujore; pra, këstet mujore tejkalojnë vlerën e të hyrave të tyre neto.

Krahas indeksit të mësipërm të ngarkesës, në studim janë përdorur gjithashtu indikatorë të tjerë si shuma e kësteve në raport me bruto të hyrat, vonesa në pagesën e kësteve, si dhe numri i kontratave aktive kreditore të huamarrësve. Dy indikatorët e fundit nuk janë të ndikuar nga

kufizimet e lartcekura në të dhëna,<sup>7</sup> andaj në kombinim me indeksin kryesor të ngarkesës me borxh paraqesin burim të mirë të informimit mbi nivelin e ngarkesës me borxh të huamarrësve.

## 2.6. Përpunimi i të dhënave

Përpunimi i të dhënave dhe nxjerrja e rezultate është bërë me programin për statistikë dhe analizë të të dhënave – STATA 11.

Relacioni mes variablave është vlerësuar duke përdorur testet si Pearson's  $CHI^2$  si dhe t-testin. Duke marrë parasysh që analiza bëhet në një mostër të klientëve, rezultatet janë testuar për rëndësinë e tyre statistikore. Pothuajse në të gjitha rastet, vetëm rezultatet që kanë rëndësi statistikore (kur vlera  $p \leq 0.05$ ) janë interpretuar. Rezultatet e tjera janë raportuar vetëm në formë grafike në Aneks 1. Duhet theksuar se rëndësia statistike e rezultateve në rastet kur ka lidhshmëri në mes të dy variablave nuk paraqet domosdoshmërisht ndërlidhje shkak-pasojë.

---

<sup>7</sup> Vonesat në pagesë dhe numri i kontratave kreditore janë të dhëna mirë të definuara që nuk lënë hapësirë për subjektivitet, mos-konsistencë dhe problem tjera të mundshme të theksuar në lidhje me indeksin e ngarkesës me borxh.

### 3. Përmbledhje e rezultateve

Ky studim është fokusuar në identifikimin e nivelit të ngarkesës me borxh të klientëve, formën e borxhit dhe masën në të cilën ngarkesa është e lidhur me problemet e pagesës së borxhit. Gjithashtu, studimi ka analizuar trendet e huamarrjes dhe pagesës së kredive, si dhe karakteristikat e huamarrësve për të kuptuar nëse karakteristika të caktuara të tyre ndërlidhen me vonesat apo nivelin e ngarkesës me borxh.

Meqenëse studimi është i pari i realizuar nga BQK në lidhje me rrezikun e ngarkesës me borxh të klientëve të bankave në Kosovë, nuk paraqet krahasim të gjendjes nëpër periudha mirëpo vlerëson gjendjen në kohën e ekstraktimit të të dhënave që është data 31 dhjetor 2013.

Më shumë se dy të tretat e huamarrësve të përfshirë në studim, më specifikisht 70 përqind, morën kredi si persona fizikë, ndërsa 30 përqind të tjerë huazuan si persona juridikë (ndërmarrje). Struktura e mostrës së kredisë është e kundërta e strukturës së gjithsej kredive në treg ku shumica e tyre (70 përqind) janë kredi për ndërmarrje ndërsa 30 përqind për ekonomi familjare. Ky fakt sugjerohet të jetë për shkak të intervalit të përzgjedhur të kredisë për këtë studim, ku në shumicë deri në 50,000 huazojnë më shumë personat fizikë ndërsa personat juridikë apo ndërmarrjet marrin kredi në intervale më të larta. Rezultatet kryesore të studimit, të ndara sipas aspekteve kryesore të shtjelluara, janë elaboruar shkurtimisht në vijim.

#### 3.1. Trendet e huamarrjes

**Shumica e huamarrësve ishin të përfshirë në huamarrje të shumëfishtë: 72 përqind e gjithsej huamarrësve kishin më shumë se një kontratë kreditore aktive.** Huamarrësit në mesatare kishin 2.6 kontrata aktive dhe se numri i kontratave ishte më i lartë për ndërmarrjet në krahasim me huamarrësit individualë.

**Huamarrësit me katër apo më shumë kontrata kreditore aktive kishin pjesëmarrje të konsiderueshme.** Pothuajse një çerek e gjithsej huamarrësve kishin katër apo më shumë kontrata aktive kreditore.

**Huamarrja nga institucione të ndryshme ishte mjaft e shprehur: 40 përqind e gjithsej huamarrësve kishin kontrata aktive kreditore nga institucione të ndryshme.** Në mesatare, huamarrësit kishin kredi aktive të lëshuara nga 1.5 institucione, ndërsa numri maksimal i kredive aktive arrinte në 6.

**Huamarrja nga institucione të ndryshme rritej me numrin e kontratave aktive.** Mesatarja e institucioneve kredidhënëse për klientët me më shumë se katër kredi aktive ishte 2.6 për dallim nga mesatarja e përgjithshme prej 1.5.

**Produkti më i shpeshtë kreditor ishin kreditë:** Më shumë se gjysma e kontratave aktive kreditore të huamarrësve ishin kredi (53 përqind), pasuar nga mbitërheqjet dhe kartelat e kreditit të cilat përfaqësuan 22 përqind, respektivisht 21 përqind të gjithsej kontratave aktive kreditore. Llojet e tjera të kontratave kreditore<sup>8</sup> përbënin vetëm 5 përqind të gjithsej portofolit kreditor.

**Më pak se gjysma e kontratave aktive kreditore ishin të kolateralizuara me koletaral vetanak të huamarrësve:** Vetëm 43 përqind e kontratave aktive kreditore ishin të kolateralizuara me kolatere vetanak nga huamarrësi, ndërsa informacionet për kolateralin që të

<sup>8</sup> Në regjistrin e kredive, llojet e kredive kategorizohen si në vijim: 1) kreditë; 2) mbitërheqjet; 3) kreditkartelat; 4) asete të tjera kreditore; 5) letrat e kreditit; 6) garancionet; 7) obligime të tjera kreditore; dhe 7) lizingu. Për qëllime të lehtësimit të analizës, pesë kategoritë e fundit janë grupuar në një kategori të cilës i referohemi me lloje të tjera të kontratave kreditore.



tjerët mund të kenë vënë në dispozicion nuk është i disponueshëm. Vlera mesatare e kontratave kreditore me kolateral vetanak ishte më e lartë nga ato pa koletaral vetanak.

**Bashkëhuamarrja ishte e shprehur në 16 përqind të huamarrësve:** në të gjitha rastet, bashkëhuamarrës ishin klientët individualë, ndërsa ndërmarrjet nuk kishin raste të përfshirjes në bashkëhuamarrje. Rastet më të shpeshta të angazhimit në bashkëhuamarrje ishin të huamarrësit të cilët kishin kontratë kreditore aktive dhe ato shpeshtoheshin me rritjen e numrit të kontratave aktive.

**Roli i garantuesit në kontrata të tjera kreditore ishte prezent në një të katërtën e gjithsej huamarrësve:** Huamarrësit me më shumë se një kontratë kreditore aktive të vetën kishin më shumë tendencë të jenë gjithashtu garantues të kredive tjera kreditore dhe kjo tendencë rritej me rritjen e numrit të kontratave kreditore që i posedonin huamarrësit.

### 3.2. Performanca e pagesës

**Huamarrësit me vonesa më shumë se 30 ditë në pagesën e kësteve të kontratave kreditore përbënin 11 përqind të gjithsej huamarrësve.** Nga huamarrësit me vonesa, shumica kishin vonesë në vetëm një kontratë kreditore, ndërsa numri maksimal i kontratave të vonuara arrinte në 7. Në mesatare, klientët kishin 1.6 kontrata kreditore me vonesë në pagesë mbi 30 ditë.

**Vonesat e pagesës të kontratave kreditore për periudha më të gjata ishin më të shpeshta.** Huamarrësit me vonesë në pagesën e këstit për më shumë se 90 ditë përbënin 7.7 përqind të gjithsej huamarrësve, ndërsa ata me vonesë mbi 180 ditë përbënin 4.9 përqind të gjithsej huamarrësve. Shumica e huamarrësve me vonesë në pagesë për periudhë më të gjatë kishin vonesë në vetëm një kontratë kreditore, ndërsa maksimumi i kontratave kreditore me vonesë mbi 90 ditë arriti në 7.

**Ndërmarrjet kishin më shumë vonesa në krahasim me huamarrësit individualë.** Ndërmarrjet kishin vonesa më shumë se 30 ditë në pagesën e kësteve kreditore në 16.4 përqind të rasteve, në krahasim me 8.7 përqind të huamarrësve individual. Lloji i veprimtarisë<sup>9</sup> së ndërmarrjes nuk kishte lidhshmëri me performancën e pagesës, ndërsa përvoja apo vjetërsia e ndërmarrjeve rezultoi të ketë lidhshmëri në kuptimin që vonesat ishin më të shprehura të ndërmarrjet me përvojë pune më të gjatë – mbi gjashtë vite.

**Performanca e pagesës, pas një trendi stabil për periudhën 2008 – 2011, përkeqësohet në vitin 2012.** Pjesëmarrja e pagesave me vonesë më shumë se 30 ditë në gjithsej pagesat e realizuara gjatë vitit fillon përkeqësimin në vitin 2012, ku ky raport pothuajse dyfishohet krahasuar me vitin paraprak. Në vitin 2012, raporti arrin në 4.4 përqind nga 2.6 përqind në 2011 (mesatarja për vitet 2008 – 2011 ishte 2.5%). Trendi i përkeqësimit të performancës është shpejtuar në vitin 2013 ku pjesëmarrja e pagesave me vonesë në gjithsej pagesat arrin në 6.4%.

**Trendi i performancës së pagesës tregon ngjashmëri me trendin e aktivitetit ekonomik në vend.** Rritja ekonomike në vend nga viti 2008 deri në vitin 2011 ishte afër 4%, ndërsa viti 2012 shënoi përkeqësim të aktivitetit ku norma e rritjes vjetore të PBB-së zbriti në 2.8%. Ky zhvillim përkon me trendin e performancës së pagesës së kredive, ku viti 2012 shënon periudhën e fillimit të përkeqësimit të performancës së pagesës së kredive. Një lidhje e tillë sugjeron që aktiviteti në sektorin real të ekonomisë së Kosovës dhe performanca e pagesës të kredive kanë

<sup>9</sup> Statistikat e kredive joperformuese të sektorit bankar tregojnë dallime në normën e kredive joperformuese nëpër sektorë të ndryshëm të ekonomisë, që nënkupton që ndërmarrjet dallojnë në vonesa të kredive varësisht prej sektorëve në të cilët veprojnë. Arsytet pse në këtë studim nuk është gjetur lidhshmëri mund të jetë numri i vogël i ndërmarrjeve të përfshira në mostër, mungesa e të dhënave të plota për llojin e veprimtarisë, si dhe ndryshimet në metodologjinë e klasifikimit të llojit të veprimtarisë.

relacion të drejtë dhe rënia e performancës së sektorit real mund të ketë ndikuar në rënien e performancës së pagesës të kredive.

**Huamarrja e shumëfishtë në më shumë se një institucion tregoi lidhshmëri me përkeqësimin e performancës së pagesës të kredive nga klientët.** Huamarrësit që posedonin disa kontrata aktive kreditore të lëshuara nga institucione të ndryshme kishin më shpesh raste të vonesave në pagesë. Ndërsa, huamarrja e shumëfishtë nga vetëm një institucion nuk kishte lidhshmëri me vonesë në pagesë.

**Kontratat kreditore që ishin më afër maturimit kishin performancë më të dobët të pagesës.** Kontratat kreditore të cilat ishin në fazën e dytë të maturimit (50% e kohëzgjatjes së kontratës ka përfunduar) kishin raste të vonesës në pagesë prej më shumë se një muaj në 6.7 përqind të rasteve, në krahasim me 4.2 përqind të kontratave në fazën e parë të maturimit.

**Vonesa në pagesat e kredive që ishin bashkëhuamarrje<sup>10</sup> ndërlidhej me vonesat në pagesat e kontratave të tjera individuale kreditore që posedonte klienti bashkëhuamarrës.** Huamarrësit me vonesa në pagesat e bashkëhuamarrjeve kishin gjithashtu vonesa në pagesat e kontratave kreditore individuale në 33 përqind të rasteve, në krahasim me vetëm 8 përqind të huamarrësve të cilët nuk kishin vonesa në pagesën e bashkëhuamarrjeve.

**Performanca e pagesës ishte më e dobët te huamarrësit e mbingarkuar.** Huamarrësit që në mesatare kishin nivel më të lartë të ngarkesës me borxh kishin raste më të shpeshta të vonesës në pagesë për më shumë se një muaj, veçanërisht huamarrësit josolvent, të cilët në 19 përqind të rasteve kishin vonesa në pagesat e borxhit. Gjithashtu, ngarkesa me borxh ndërlidhet me performancën më të dobët të pagesës edhe në rastin e shqyrtimit të veçantë të pagesave me vonesë prej më shumë se 3 muaj, të cilat në vetvete konsiderohen si një indikator i ngarkesës me borxh të huamarrësit.

Si përfundim, përkeqësimi i performancës së pagesës së huamarrësve paraqitet të ketë pasur lidhshmëri me disa karakteristika të huamarrësve, trende të huamarrjes, si dhe me faktorë të jashtëm. Vonesat në pagesë të kredisë ishin më të shpeshta te ndërmarrjet - sidomos ato me përvojë më të gjatë në biznes; te huamarrësit me disa kontrata kreditore nga institucione të ndryshme kredidhënëse; te huamarrësit me vonesë në kthimin e bashkëhuamarrjeve, si dhe te huamarrësit me nivel më të lartë të ngarkesës me borxh. Vonesat në pagesë treguan lidhshmëri me aktivitetin ekonomik në vend, ku periudhat e rritjes më të ngadalshme ekonomike korresponduan me periudhat e përkeqësisimit të performancës së pagesës së kësteve kreditore.

### 3.3. Ngarkesa me borxh

Ngarkesa me borxh është vlerësuar përmes konstruktimit të indeksit kryesor të ngarkesës,<sup>11</sup> i cili është llogaritur veçmas për klientët individualë dhe për ndërmarrjet. Në rastin e individëve, janë marrë për bazë të hyrat mujore të ekonomisë familjare, përkatësisht të hyrat mujore neto pas pagesës së taksave dhe shpenzimeve mujore, ndërsa për bizneset është marrë për bazë profiti neto. Indeksi, në të dy rastet është kalkuluar si raport i shumës së borxhit (të gjitha kësteve mujore) të huamarrësit ndaj të hyrave mujore neto.

Krahas indeksit kryesor të ngarkesës është kalkuluar edhe indeksi alternativ, që merr për bazë të hyrat mujore bruto. Ky indeks është llogaritur ndaras për ekonomitë familjare dhe ndërmarrjet. Huamarrësit cilësohen të mbingarkuar me borxh në rastin kur shumata e këstit

<sup>10</sup> Kreditë për të cilat klienti në fjalë është bashkëhuamarrës dhe johuamarrës i vetëm.

<sup>11</sup> Niveli i ngarkesës me borxh sipas indeksit kryesor është kategorizuar si në vijim: a) Të pangarkuar me borxh, kur raporti i këstit ndaj të hyrave neto është nën 50 përqind; b) Në rrezik, kur indeksi i ngarkesës me borxh është mes 50 -75 përqind; c) Në fazë kritike, kur indeksi është mes 75 – 100 përqind, dhe d) Josolvent, kur indeksi tejkalon vlerën 100 përqind.

mujor të kontratave kreditore tejkalon 50% të të hyrave mujore bruto (BIS 2010). Duhet theksuar se indeksi alternativ është shfytëzuar vetëm për vlerësimin e nivelit të ngarkesës në përgjithësi, duke mos analizuar ndërlidhjen e tij me faktorët e tjerë si në rastin e indeksit kryesor të ngarkesës. Gjithashtu, ky indikator ka peshë më të vogël në komentimin e rezultateve të ngarkesës për ndërmarrjet për arsye të variabilitetit të madh të të hyrave bruto dhe nivelit të shpenzimeve tëndërmarrjeve<sup>12</sup> në raport me ekonomitë familjare të cilat tentojnë të kenë shpenzime më stabile.

**Afër 40 përqind e gjithsej huamarrësve (ekonomi familjare dhe ndërmarrje) kanë problem me mbingarkesë të borxhit, ku vlera e kështit mujor tejkalon mbi 50 përqind të hyrave mujore neto.** Ekonomitë familjare kishin më shumë raste të mbingarkesës me borxh, ku 44.7 përqind e tyre shpenzuan më shumë se 50 përqind të hyrave për pagesë të kësteve (figura 1), në krahasim me 36 përqind të ndërmarrjeve (figura 2).

Sidoqoftë, ndërmarrjet kishin raste më të shpeshta të mbingarkesës së nivelit më të lartë, ku 19.3 përqind e tyre ishin josolvent në raport me vetëm 8.4 përqind të individëve. Gjetjet e studimit për ngarkesën e ekonomive familjare mbështeten edhe nga Anketa e Buxhetit të Ekonomive Familjare të Agjencionit të Statistikave të Kosovës, rezultatet e së cilës për vitin 2013 sugjerojnë që 44 përqind e ekonomive familjare nuk kanë mundur të përballojnë pagesat siç janë qiraja, kreditë, tatimet, shpenzimet komunale – faturat, mirëmbajtje të rregullta etj.<sup>13</sup>

**Indeksi alternativ i ngarkesës me borxh i bazuar në raportin e kështit mujor ndaj të hyrave mujore bruto sugjeron që 17.8 përqind të ekonomive familjare janë të mbingarkuara.** Nga gjithsej huamarrësit individual, 82.2 përqind shpenzonin më pak se 50% të hyrave mujore bruto familjare në pagesën e kësteve, ndërsa pjesa tjetër prej 17.8 përqind shpenzonin më shumë se 50 përqind të të hyrave bruto mujore në pagesën e kësteve mujore.

**Sa i përket ndërmarrjeve, indeksi alternativ i ngarkesës me borxh i bazuar në raportin e kështit mujor ndaj të hyrave mujore bruto sugjeron që 7.85 përqind të ndërmarrjeve janë të mbingarkuara.** Nga gjithsej ndërmarrjet, 91.5 përqind shpenzojnë më pak

Figura 1. Shpërndarja e huamarrësve individual sipas indeksit të ngarkesës





Figura 2. Shpërndarja e ndërmarrjeve sipas indeksit të ngarkesës



<sup>12</sup> Të hyrat bruto të ndërmarrjeve nuk mund të konsiderohen si indikator i kënaqshëm për matjen e ngarkesës me borxh ngase kapaciteti i pagesës së kështit varet nga profiti i cili afektohet nga shpenzimet. Në rastin e ndërmarrjeve të mëdha, të hyrat bruto kanë tendencë të jenë shumë të larta dhe ngarkesa me borxh e ndërmarrjes mund të rezultojë e ulët (raporti kështit mujor ndaj të hyrave bruto). Mirëpo, në këto raste, shpenzimet mund të jenë gjithashtu shumë të larta, andaj dhe kapaciteti për pagesën e kredive mund të mbivlerësohet.

<sup>13</sup> Megjithëse qasja e ASK-së në vlerësimin e mospërbalueshmërisë së pagesave është më gjithëpërshirëse dhe ndryshon nga metodologjia e vlerësimit të mbingarkesës në këtë studim, indikatorit i mospërbalueshmërisë së pagesave për dy ose më shumë herë mund të konsiderohet si mates i ngarkesës së ekonomive familjare.

se 50% të qarkullimit bruto mujor për pagesën e kësteve mujore. Sidoqoftë, ashtu siç është cekur më lartë në këtë seksion, pesha e komentimit të këtij indeksi për ndërmarrjet është më e vogël dhe rezultatet duhet të interpretohen duke marrë parasysh kufizimet e lartcekura.

**Ngarkesa me borxh dhe numri i kontratave aktive kreditore tregojnë lidhshmëri.** Si në rastin e ekonomive familjare, ashtu edhe te ndërmarrjet, posedimi i më shumë kontratave kreditore është i lidhur me ngarkesën me borxh ku huamarrësit me më shumë se një kontratë kreditore kishin më shumë raste të mbingarkesës dhe problemet shpeshtoheshin me shtimin e numrit të kontratave kreditore. Tek ekonomitë familjare, 35 përqind e huamarrësve me një kontratë kreditore kishin probleme me ngarkesë në krahasim me 48 përqind të atyre me më shumë se një kontratë kreditore. Ndërsa, te ndërmarrjet, 11 përqind e huamarrësve me një kontratë kreditore kishin probleme me ngarkesë në krahasim me 47 përqind të atyre me më shumë se një kontratë kreditore.

**Huamarrja nga më shumë së një institucion kishte lidhshmëri me ngarkesën me borxh për ndërmarrjet.** Afër 37 përqind e ndërmarrjeve me disa kontrata aktive kreditore nga i njëjti institucion kishin probleme të ngarkesës me borxh, për dallim nga 56 përqind të atyre me kontrata kreditore nga disa institucione. Rastet e josolvencës ishin shumë më të shpeshta në huamarrjen nga disa institucione, ku 32 përqind e ndërmarrjeve ishin josolvenete karahas 18 përqind të ndërmarrjeve që kishin kredi të shumta por nga i njëjti institucion.

**Posedimi i mbitërheqjeve dhe kreditkartelave kishte ndikim në nivelin e ngarkesës.** Huamarrësit individualë që kishin mbitërheqje në portofolin e tyre kreditor kishin më shumë raste të mbingarkesës. Gjithashtu, shfrytëzuesit aktiv të mbitërheqjeve - që nënkupton huamarrësit të cilët me datën e ekstraktimit të të dhënave për studim kishin borxh të mbetur në mbitërheqje - kishin më shumë raste të mbingarkesës. Te ndërmarrjet, niveli i ngarkesës me borxh dallonte mjaft shumë varësisht nga fakti se a posedonte ndërmarrja mbitërheqje dhe/apo kreditkartelë në portofolin kreditor dhe niveli i ngarkesës ishte më i lartë në rastet e përdorimit aktiv të këtyre produkteve. Megjithatë, për shkak të specifikave të këtyre produkteve kreditore, ku gjithsej shumica e lejuar është raportuar si shumë e mbetur borxh, problemet e ngarkesës me borxh mund të mos jenë pasqyruar si duhet duke pasë tendencë për mbivlerësim të ngarkesës me borxh.

**Lloji i vendbanimit të huamarrësve kishte lidhshmëri me ngarkesën me borxh.** Në rastin e ekonomive familjare, huamarrësit e vendeve urbane kishin në përgjithësi më shpesh probleme të ngarkesës me borxh në krahasim me huamarrësit e vendeve rurale, por që rastet e josolvencës ishin më të shpeshta në vendet rurale. Sa i përket ndërmarrjeve, rastet e josolvencës ishin më të shpeshta në vende urbane.

**Lidhshmëri me ngarkesën me borxh kishte edhe mosha e huamarrësve.** Në përgjithësi, huamarrësit e moshës së mesme kishin më shpesh probleme të ngarkesës me borxh.

**Ngarkesa me borxh te ndërmarrjet kishte lidhshmëri edhe me historikun kreditor.** Ndërmarrjet që morën kredi për herë të parë ishin më pak të ngarkuara me borxh, dhe niveli i ngarkesës ishte më i lartë sa më e gjatë që ishte historia kreditore e ndërmarrjeve.

**Kolaterali në kreditë kreditore kishte lidhshmëri me nivelin e ngarkesës së huamarrësve.** Huamarrësit të cilët nuk kishin mbështetur asnjë kontratë të tyre kreditore me kolateral kishin shumë më pak tendencë për ngarkesë me borxh, në krahasim me klientët të cilët kishin lënë kolateral.

Rezultatet e studimit sugjerojnë që ka lidhshmëri statistikisht të rëndësishme në mes të nivelit të ngarkesës me borxh të huamarrësve, si dhe faktit nëse i është lëshuar ndonjë kontratë e re kreditore huamarrësit në fjalë pas kredisë, e cila është marrë për bazë gjatë përzgjedhjes së mostrës për këtë studim. Huamarrësit të cilët kanë nënshkruar kontratë tjetër kreditore kanë

më shpesh probleme me ngarkesë me borxh sesa huamarrësit të cilët nuk kanë nënshkruar kontrata të tjera. I njëjti rezultat vlen edhe në analizën e bërë ndaras për huamarrësit individualë dhe ndërmarrjet. Përderisa ky rezultat mund të përputhet me gjetjen se problemet e ngarkesës me borxh rriten me rritjen e numrit të kontratave kreditore, ekziston gjithashtu mundësia që ngarkesa me borxh të jetë mbivlerësuar për shkak të mos llogaritjes së rritjes së mundshme të të hyrave dhe kapacitetit kredimarrës të huamarrësve.<sup>14</sup>

### 3.4. Ndërlidhja mes indikatorëve të ndryshëm të ngarkesës

Ngarkesa me borxh e klientëve, ashtu siç është elaboruar në pjesën e metodologjisë, nuk ka definicion dhe mënyrë standarde të vlerësimit. Indikatorë të ndryshëm përdorën për të vlerësuar aspekte të ndryshme të ngarkesës, në mënyrë që të arrihet te një pasqyrë më reale e problematikës. Në këtë studim është bërë vlerësimi i ngarkesës përmes disa indikatorëve, si dhe është testuar dhe analizuar ndërlidhja mes tyre.

Problemet në performancën e pagesës së huamarrësve rezultuan të jenë të ndërlidhura me nivelin më të lartë të ngarkesës me borxh sipas indeksit kryesor që merr për bazë të hyrat mujore neto. Huamarrësit me vonesa më shumë se 30 ditë kishin pothuajse dy herë më shumë raste të josolvensës në krahasim me huamarrësit pa probleme në pagesën e kredive. Mirëpo, performanca nuk tregoi lidhshmëri me indeksin alternativ të ngarkesës (që merr për bazë të hyrat mujore bruto), e as me huamarrjen e shumëfishtë apo posedimin e katër apo më shumë kontratave kreditore. Sidoqoftë, vonesat në pagesë për më shumë se 3 muaj, u asocuan me nivel më të lartë të ngarkesës, si dhe me posedimin e katër apo më shumë kontratave kreditore. Mungesa e ndërlidhjes së performancës së përgjithshme të pagesës me indikatorët e tjerë të ngarkesës ka arsyeshmëri për shkak se, ashtu siç është cekur në seksionin 2.5, vetëm vonesat më të gjata se 3 muaj (vonesat strukturore) në pagesën e obligimeve kreditore cilësohen si indikatorë të mbingarkesës.

Indeksi i ngarkesës me borxh sipas të hyrave neto tregoi korrelacion të lartë me indeksin alternativ të ngarkesës që për bazë merr të hyrat bruto. Niveli më i lartë i ngarkesës, sipas të dy këtyre indekseve, u asocua me huamarrje të shumëfishtë, ku niveli më i lartë i ngarkesës ishte te huamarrësit me katër apo më shumë kontrata kreditore.

Si përfundim, mund të sugjerohet se niveli i ngarkesës me borxh të huamarrësve asocohet me performancën më të dobët të pagesës, si dhe me posedim të shumë kontratave aktive kreditore. Megjithatë, relacioni shkak-pasojë ndërmjet këtyre faktorëve nuk është i përcaktuar, dhe mund të zhvillohet në kahje të ndryshme. Posedimi i më shumë kontratave kreditore patjetër ndikon në rritjen e borxhit mujor për pagesë dhe ka ndikim në rritjen e nivelit të ngarkesës me borxh të huamarrësve; megjithatë, ekziston mundësia që huamarrësit të marrin borxh shtesë për servisim të borxhit ekzistues në rastet e pamundësisë së pagesës, dhe në këtë mënyrë të ndikojnë në mbingarkesë. Vonesat në pagesë, në anën tjetër, jodomosdoshmërisht nënkuptojnë ngarkesë me borxh të huamarrësve me që ato mund të paraqesin ndryshime të përkohshme në të hyrat dhe shpenzimet e huamarrësve. Gjithashtu, ngarkesa me borxh nuk rezulton domosdoshmërisht në vonesa, ngase huamarrësit mund të përdorin burime të tjera të pagesës së borxhit kreditor, siç janë kursimet, huamarrjet nga familjarët, etj.

<sup>14</sup> Kjo ngase informatat për të hyrat mujore janë marrë në kohën e marrjes së kredisë që ka shërbyer për përzgjedhjen e mostrës së klientit, dhe janë supozuar konstante në peridhurat në vijim për shkak të mungesës së informacionit të përditësuar për të hyrat e klientëve. Ndërsa, informatat për kontratat kreditore që janë marrë pas kontratës mostër janë në dispozicion në RKK dhe janë përfshirë në analizë.

## 4. Përfundim

Sektori bankar në Kosovë ka hyrë në dekadën e dytë të funksionimit. Thellimi i ndërmjetësimit financiar (kreditimit) ka rol të rëndësishëm në financimin e ekonomisë dhe mbështetjen e zhvillimit ekonomik. Sidoqoftë, rritja e shpejtë mund të sjellë probleme të mbingarkesës me borxh të klientëve të cilat mund të reflektohen negativisht në sektorin financiar, por që gjithashtu mund të kenë efekte ekonomiko-sociale për huamarrësit dhe për ekonominë e vendit në tërësi.

Ngarkesa me borxh e klientëve nuk ka definicion dhe mënyrë standarde të vlerësimit, andaj në këtë studim janë përdorur indikatorë të ndryshëm për të vlerësuar aspekte të ndryshme të ngarkesës, në mënyrë që të arrihet te një pasqyrë më reale e problematikës. Indikator i kyç është konsideruar të jetë indeksi i ngarkesës me borxh, i cili është kalkuluar si raport i shumës së borxhit për pagesë mujore (të gjitha kësteve mujore) të huamarrësit ndaj të hyrave mujore neto. Indikatorë alternativë të ngarkesës janë cilësuar performanca e pagesës, posedimi i më shumë se katër kontratave kreditore, si dhe indeksi i ngarkesës me të ardhurat bruto.

Gjetjet e studimit sugjerojnë se afër 40 përqind e gjithësej huamarrësve (ekonomi familjare dhe ndërmarrje) kanë problem me ngarkesë të borxhit, ku vlera e kështit mujor tejkalon mbi 50 përqind të të hyrave mujore neto. Ekonomitë familjare kishin më shumë raste të ngarkesës me borxh, ku 44.7 përqind e tyre shpenzonin më shumë se 50 përqind të hyrave për pagesë të kësteve, në krahasim me 36 përqind të ndërmarrjeve. Sidoqoftë, ndërmarrjet kishin raste më të shpeshta të ngarkesës së nivelit më të lartë, ku 19.3 përqind e tyre ishin josolvent (shuma mujore e kësteve tejkalon të hyrat mujore neto) në raport me 8.4 përqind të individëve. Niveli i ngarkesës së huamarrësve kishte dallime sipas disa karakteristikave demografike të huamarrësve, si dhe disa preferencave kreditore. Ndër më të rëndësishmet është dallimi në ngarkesën me borxh në grupet e huamarrësve që përdornin mbitërheqje dhe kreditkartela në portofolin e tyre kreditor. Huamarrësit që posedonin mbitërheqje, si dhe shfrytëzuesit aktiv të mbitërheqjeve dhe kreditkartelave - që nënkupton huamarrësit të cilët me datën e ekstraktimit të të dhënave për studim kishin borxh të mbetur në mbitërheqje - kishin më shumë raste të mbingarkesës. Dallimi ishte më i theksuar sidomos te ndërmarrjet, ku niveli i ngarkesës me borxh ishte mjaft më i lartë në rastet e përdorimit aktiv të këtyre produkteve (vetëm 25 përqind të ndërmarrjeve që nuk përdornin mbitërheqjet kishin problem me ngarkesë me borxh krahasuar me 50 përqind të atyre që përdornin këtë produkt). Megjithatë, për shkak të specifikave të këtyre produkteve kreditore, ku gjithësej shuma e lejuar është raportuar si shumë e mbetur borxh, problemet me ngarkesë me borxh në rastet e përdorimit të mbitërheqjeve mund të jenë të mbivlerësuara.

Indeksi alternativ i ngarkesës me borxh, i cili merr për bazë të hyrat mujore bruto, sugjeron që 17.8 përqind të ekonomive familjare janë të mbingarkuara, në kuptimin që shpenzonin më shumë se 50 përqind të të hyrave mujore bruto familjare në pagesën e kësteve. Sa i përket ndërmarrjeve, indeksi sugjeron që 18 përqind e tyre shpenzojnë më shumë se 30 përqind të qarkullimit mujor në pagesën e kësteve mujore kreditore, ndërsa 7.9 përqind shpenzojnë mbi 50 përqind të qarkullimit mujor.

Përkundër nivelit relativisht të lartë të ngarkesës së gjithësej huamarrësve të sugjeruar sipas indeksit të ngarkesës, vonesat në pagesa të kësteve kishin pjesëmarrje më të ulët. Huamarrësit me vonesa më shumë se 30 ditë në pagesën e kësteve të kontratave kreditore përbënin 11 përqind të gjithësej huamarrësve. Vonesat në pagesë ishin më të shpeshta te ndërmarrjet, megjithëse huamarrësit individualë kishin më shpesh probleme me ngarkesë me borxh. Një rezultat i tillë sugjeron që ngarkesa me borxh jodomosdoshmërisht reflektohet me vonesa në pagesë të kredive, ngase huamarrësit mund të sigurojnë vazhdimësi në pagesë përmes burimeve

tjera të financimit si huamarrja nga familjarët, remitencat, kursimet, etj. Gjithashtu, huamarrësit në përgjithësi mund të vonohen në pagesën e detyrimeve tjera buxhetore si pagesat e shërbimeve komunale, etj. Sidoqoftë, vonesat në pagesë për më shumë se 3 muaj - që përdoren si indikacion i vonesave stukturore që sugjerojnë ngarkesë të klientëve - u shoqëruan me nivel më të lartë të ngarkesës me borxh.

Faktorët tjerë që u shoqëruan me performancë të përkeqësuar të pagesës ishin përvoja e punës së ndërmarrjes, që mund të sugjerojë se bankat janë më të prirura për dhënie të kredive me rrezik më të lartë ndërmarrjeve me përvojë më të gjatë të punës, ndërsa janë më të vëmendshme për ndërmarrjet e reja. Marrja e kredive nga institucione të ndryshme, si dhe përfshirja në bashkëhuamarrje me vonesë në pagesë reflektoheshin në performancë më të dobët. Performanca e pagesës përkeqësohej në fazat më të vonshme të maturimit të kontratave kreditore, që reflekton faktin se rreziku është më i paparashikueshëm për periudha më të largëta. Përfundimisht, vonesat në pagesë treguan lidhshmëri me aktivitetin ekonomik në vend, ku periudhat e rritjes më të ngadalshme ekonomike koinciduan me periudhat e përkeqësimit të performancës së pagesës së kësteve kreditore.

Gjetjet e studimit sugjerojnë se faktorët kryesorë që shoqërohen me nivel më të lartë të ngarkesës me borxh, të vlerësuar sipas indeksit të ngarkesës përfshijnë: huamarrjen e shumëfishtë, në veçanti huamarrjen e njëkohësishme nga disa institucione të ndryshme; historikun më të gjatë kreditor; posedimin dhe përdorimin aktiv të mbitërheqjeve dhe produkteve të tjera kreditore; vënien në dispozicion të kolateralit në kreditë e veta, lloji i vendbanimit, etj.

#### 4.1. Kufizimet e Studimit

Gjetjet e studimit mund të jenë subjekt i disa kufizimeve në cilësinë e të dhënave. Më konkretisht, kalkulimi i indeksit të ngarkesës me borxh është subjekt i disa mangësive në lidhje me të dhënat e shfrytëzuara, si dhe gabimeve të mundshme në raportim të këtyre të dhënave. Të dhënat për këstin mujor nuk kanë qenë në dispozicion për të gjitha kreditë aktive, andaj është bërë kalkulimi duke shfrytëzuar normën mesatare të interesit për produktet përkatëse. Gjithashtu, në raste të disa produkteve kreditore siç janë mbitërheqjet, linjat kreditore dhe kreditë e mbuluara me para të gatshme, kësti mujor është raportuar në vlerë të barabartë me shumën totale të aprovuar të produktit kreditor, megjithëse afati i maturimit të produktit ishte më i gjatë, gjë që mund të mbivlerësoj nivelin e ngarkesës me borxh.

Një mangësi tjetër e indeksit ka të bëjë me cilësinë e të dhënave për të hyrat e individëve dhe ndërmarrjeve. Kjo përfshin moskonsistencën e mundshme ndërmjet institucioneve për sa i përket mënyrës së llogaritjes së të hyrave neto në dispozicion të huamarrësve. Problem tjetër mund të jetë vjetërsia e të dhënave për të hyrat mujore neto të disponueshme, e cila ka ndikim sidomos në rastet kur të hyrat e huamarrësve janë rritur në periudhën ndërmjet kohës kur banka ka bërë regjistrimin e të hyrave të tyre dhe datës së studimit, gjë që nënkupton se kapaciteti për marrje të kredive shtesë të huamarrësve është rritur. Andaj, në rastet kur huamarrësi ka marrë kredi shtesë pas kredisë që është shfrytëzuar si mostër për përzgjedhjen e huamarrësve, ekziston mundësia që indeksi i ngarkesës me borxh të jetë mbivlerësuar. Kjo mundësi e mbivlerësimit mbështetet nga fakti se rezultatet e studimit sugjerojnë për dallime të konsiderueshme në mes të nivelit të ngarkesës me borxh të huamarrësve, që nuk kanë marrë kredi tjetër pas kredisë së shqyrtuar në mostër dhe huamarrësve të cilëve i është lëshuar ndonjë kontratë e re kreditore pas kredisë, e cila është marrë për bazë për përzgjedhjen e mostrës për këtë studim. Huamarrësit të cilët kanë nënshkruar kontratë tjetër kreditore kanë rezultuar më shpesh të kenë pasur probleme të ngarkesës me borxh.

Studimi është i limituar në paraqitjen e gjendjes dhe ndërlidhjen mes indikatorëve të ndryshëm të ngarkesës, karakteristikave demografike dhe preferencave/trendëve të huamarrjes në kuptimin që nuk informon mbi ndërlidhjen shkak-pasojë. Gjithashtu, studimi nuk analizon në detaje faktorët e ngarkesës me borxh dhe pasojat e saj, nuk ka qasje gjithëpërfshirëse ndaj faktorëve që ndikojnë në ngarkesën me borxh – faktorët që ndikojnë të hyrat dhe shpenzimet -, si dhe nuk analizon efektet e ngarkesës me borxh për huamarrësit dhe ekonominë në tërësi.



## 5. Rekomandime

Ngarkesa me borxh apo rreziku i mbingarkesës me borxh është problem kompleks dhe shumëdimensional. Bashkëveprimi midis faktorëve të shumtë, që ndikojnë në mbingarkesë bënë që mos të ketë mënyrë të lehtë për vlerësimin e këtij problemi dhe adresimin e tij. Vlerësimi i rrezikut të mbingarkesës nuk mund të reduktohet në një indikator të vetëm ashtu siç nuk mund të mendohet një mënyrë e vetme për adresimin e rrezikut të mbingarkesës. Përkundrazi, problemi duhet të shikohet nga shumë aspekte, duke mbledhur, vlerësuar dhe analizuar të dhëna nga tregues të shumtë në mënyrë që të kuptohet dhe pasqyrohet fotografia e plotë e tij. Natyra komplekse e problemit thekson nevojën për ndërveprim të institucioneve dhe kombinim të metodave e masave. Të dhënat në dispozicion janë të kufizuara dhe në përgjithësi, kërkohet më shumë angazhim i të gjitha palëve relevante në mbledhjen dhe ofrimin e të dhënave cilësore. Disa rekomandime në lidhje me masa të mundshme që mund të ndërmerren nga palët e interesit, të cilat dalin në mënyrë të natyrshme nga gjetjet e studimit, si dhe nga konsultimet e materialeve dhe palëve relevante, janë paraqitur në vijim:

### Aplikimi i vazhdueshëm i praktikave të përgjegjshme të kreditimit

- Ndjekja e politikave të kreditimit të përgjegjshëm nga institucionet kredidhënëse, që nënkupton vlerësimin e kujdesshëm të kapacitetit kredimarrës të klientëve është mënyra më tipike dhe e drejtpërdrejtë e parandalimit të problemit të ngarkesës me borxh;
- Posedimi i shumë kontratave kreditore rezultoi të jetë i lidhur me ngarkesën me borxh dhe rreziku i ngarkesës rritej me shtimin e numrit të kontratave kreditore. Për më tepër, shqyrtimi i literaturës dhe studimeve të ndryshme sugjeron se posedimi i katër apo më shumë se katër kontratave paraqet në vetvete tregues të rrezikut të ngarkesës me borxh (BIS, 2010) dhe (D'Alessio & Iezzi 2013). Andaj, institucionet kredidhënëse duhet të kenë parasysh këtë fakt dhe të kenë kujdes të shtuar në vlerësimin e kapaciteteve për kthim të kredive për klientë të cilët kanë shumë kontrata aktive kreditore;
- Në veçanti, institucionet kredidhënëse të jenë të vëmendshme dhe të përgjegjshme në dhënien e kredive të reja te klientët të cilët kanë probleme me pagesën e kredive ekzistuese. Institucionet kredidhënëse duhet të kenë kujdes të shtuar ndaj vlerësimit të kapacitetit të klientit për kthim në rast të shqyrtimit të dhënies së kredive të reja për të mundësuar pagesën e borxheve ekzistuese, ngase kjo praktikë, megjithëse në raste të caktuara mund t'i ndihmojë huamarrësit për tejkalimin e problemeve të përkohshme financiare, gjithashtu mundet vetëm të përkeqësojë gjendjen financiare dhe kapacitetin për kthim të borxhit nga huamarrësi;
- Huamarrja e njëkohësishme nga institucione të ndryshme kredidhënëse rezultoi të ketë ndikim negativ në performancën e pagesës dhe ngarkesën me borxh. Andaj, institucionet financiare duhet të kenë kujdes në vlerësimin e rrezikut për klientët që veçse kanë kredi aktive në një tjetër institucion kredidhënës;
- Indikatori kryesor i matjes së ngarkesës me borxh në studim u cilësua të jetë raporti i borxhit mujor për pagesë të kontratave kreditore ndaj të hyrave mujore neto. Institucionet kredidhënëse sugjerohet që të kujdesen të aplikojnë tregues të adekuatshmërisë së të hyrave për pagesën e kësteve të kontratave kreditore, në rastin e lëshimit të kredive të reja duke aplikuar limit në raportin e shumës së të gjitha pagesave mujore, në të gjitha institucionet për kredi ndaj të ardhurave mujore neto. Respektimi efektiv i limiteve të tilla nga të gjitha institucionet do të ndihmonte në parandalimin e rrezikut nga mbingarkesa me borxh;

**Angazhimi në mbledhjen, përdorimin dhe shpërndarjen e informacioneve të rëndësishme**

- Sugjerohet që institucionet kredidhënëse të bëjnë monitorimin e vazhdueshëm të ndryshimeve të mundshme në të hyrat e klientëve gjatë kohës së pagesës të kredive, si dhe të regjistrojnë këto ndryshime. Përdorimi i programeve informative për regjistrimin e të dhënave të klientëve, përfshirë të hyrat, do të mundësonte saktësi më të lartë dhe shfrytëzim më të lehtë të të dhënave për vlerësimin e gjendjes financiare dhe rrezikut të mbingarkesës së klientëve;
- Në vlerësimin e të hyrave neto nga një institucion, inkurajohet aplikimi i procedurave standarde të paracaktuara, në mënyrë që të sigurohet konsistencë dhe krahasueshmëri e të hyrave të klientëve të po atij institucioni. Dokumentimi i të hyrave bruto me kontratë, si dhe aplikimi i një metodologjie standarde të vlerësimit të shpenzimeve mujore do të ndihmonin në sigurimin e të dhënave më kualitative për krahasueshmëri dhe analizë të gjendjes së ngarkesës me borxh;
- Raportimi i këstit kreditor apo normës efektive të interesit në Regjistër të Kredive të Kosovës nga institucionet kredidhënëse, do të ndihmonte në sigurimin e të dhënave më të sakta për vlerësimin e gjendjes së ngarkesës me borxh. Andaj institucionet kredidhënëse inkurajohen që të bëjnë raportimin e këtyre të dhënave në RKK në mënyrë të rregullt, ngase raportimi i këtyre të dhënave nuk është i obliguar por bëhet në bazë vullnetare;
- Në rastin e raportimit në RKK të të dhënave të cilat janë opcionale është e rëndësishme, që bankat të rritin cilësinë e raportimit. P.sh. në rastin e raportimit për fushën "qëllimi i kredisë", bankat kanë pasur normë të kënaqshme të raportimit, mirëpo shumica e qëllimeve kanë qenë të indetifikuara si "qëllime të tjera". Andaj, inkurajohet cilësi më e mirë e raportimit përmes specifikimit dhe kategorizimit adekuat të qëllimit të kontratave kreditore.
- Zhvillimi i vazhdueshëm i RKK-së në përfshirjen e sa më shumë fushave të të dhënave, në mënyrë që të ofrojë informacion sa më të rregullt dhe të larmishëm për analizimin e tregut dhe trendeve të kredimarrjes. Përfshirja e të dhënave për performancën e pagesës së faturave të rregullta mujore të klientëve, siç janë pagesa e energjisë elektrike, shërbimeve komunale, etj. do të ishte e rëndësishme së veçantë ngase do të ofronte informacion të rëndësishëm për vlerësimin e rrezikut kreditor dhe rrezikut të ngarkesës së klientëve;
- Studime të ndryshme tregojnë për efektivitetin e edukimit financiar në parandalimin e ngarkesës me borxh, si dhe për efektivitetin e shërbimeve këshillëdhënëse në ndihmesën e klientëve për të përmirësuar menaxhimin e financave. Andaj, sugjerohet angazhim i të gjitha palëve relevante, që të bashkëpunojnë në ofrimin e programeve për edukim financiar të klientëve dhe ofrimin e këshillave për klientët e ngarkuar me borxh apo në rrezik të ngarkesës me borxh – të cilët kanë problem në pagesën e obligimeve mujore për shërbime komunale, fatura të tjera, këste të kredive, etj.

## 6. Referenca

- Agjencia e Statistikave të Kosovës (2013), Rezultatet e Anketës së Buxhetit të Ekonomive Familjare.
- Banka Qendrore e Kosovës, Departamenti i Statistikave (2013 -2014).
- Business Innovation and Skills Department of the United Kingdom Government (2010) Over-indebtedness in Britain: Second follow-up report.
- Çmimore e produkteve të bakave në Kosovë, Web-faqet zyrtare të bankave të përfshira në studim, të marra më datën 24 korrik 2014.
- D'Alessio, G., & Iezzi, S. (2013), Household Over-Indebtedness: Definition and Measurement with Italian Data, Bank of Italy.
- European Commission (2008a), Towards a common operational European definition of overindebtedness.
- European Commission (2010), Over-indebtedness: New evidence from the EU-SILC special module, Research note 4/2010.
- European Fund for Southeast Europe (2011), Study on Indebtedness of Microcredit Clients in Kosovo.
- European Fund for Southeast Europe (2012), Risk of Over-indebtedness of MSE Clients in Kosovo.
- Haas O. J. (2006), Over-indebtedness in Germany, Working Paper No. 44, International Labour Organisation: Geneva.
- OXERA (2004), Are UK households over-indebted?, Commissioned by the Association for Payment Clearing Services, British Bankers Association, Consumer Credit Association & Finance and Leasing Association.
- Regjistri i Kredive të Kosovës (2013 -2014).





Rruga Garibaldi, Nr.33, Prishtinë,  
Republika e Kosovës  
Tel: +381 38 222 055; Fax: +381 38 243 763  
Web: [www.bqk-kos.org](http://www.bqk-kos.org)